



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

---

**Kom.Dh.Shk.II.nr.54/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Faton Bajrami, në çështjen juridike të kreditorit NTSH A.G.S me seli ne Prishtinë, të cilen sipas autorizimit e përfaqëson V.M. avokat nga Mitrovica, kundër debitorit të përmbarimit “McCroft Tobacco Kosovo Limited” shpk, me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.K. jurist nga Gjilani, lidhur me çështjen përmbarimore për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur sipas ankesën së debitorit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1950/22 i datës 29.09.2023, me datën **05.03.2024** mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e debitorit të përmbarimit “McCroft Tobacco Kosovo Limited” shpk, me seli në Gjilan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë, KPPP.nr.1950/22 i datës 29.09.2023 **PRISHET** dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhoma e Shkalles se Pare në rishqyrtim dhe rivendosje

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1950/22 i datës 29.09.2023, duke vendosur sipas kërkesës propozimit të kreditorit kreditorit NTSH A.G.S me seli ne Prishtinë, e ushtruar kundër debitorit “McCroft Tobacco Kosovo Limited” shpk, me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.K. jurist nga Gjilani, e ka refuzuar ne tërësi kundërshtimin e debitorit të përmbarimit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin e përmbaruesit Atip Mustafa, për territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.34/2022 i datës 10.02.2022

Kundër këtij aktvendimi debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore/ Përmbarimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim te gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet si e bazuar në tërësi ankesa e debitorit dhe te anulohet urdheri përmbarimor apo lënda te kthehet ne rivendosje.

I autorizuari i kreditorit nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

**Ankesa e debitorit është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NTSH A.G.S me seli ne Prishtinë me seli në Prishtinë, me datën 27.01.2022 ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshem faturës, në shumën e përgjithshme prej 33,243.55€, në emër të borxhit, si dhe ka kërkuar të gjitha shpenzimet e përmbartimit nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.34/2022, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 24.02.2022, ka ushtruar prapësim duke theksuar se fatura është e parregullt, e pa bazuar dhe se nuk derivon nga raporti kontraktual, po ashtu ne kundërshtime ka theksuar se nënshkrimi ne fature është vendosur nga persona te panjohur.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar pala kreditore ku ka propozuar që të refuzohet si i pabazuar në tërësi prapësimi i debitorit dhe të lihet në fuqi urdhër përmbartimorë P.nr.34/22 i datës 24.02.2022 i lejuar përmbartuesi privat Atip Mustafa.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1950/22 i datës 29.09.2023, me të cilin e ka refuzuar kundërshtimin e debitorit të përmbartimit dhe ka lene ne fuqi urdhrin i përmbartuesit privat për territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.34/2022 i datës 10.02.2022, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se “me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozimin për përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshem - faturës ku është lejuar përmbartimi në shumën prej 33,243.55€”. Ka arsyetuar se lënda e procedurës së përmbartimit është caktimi dhe zbatimi i ekzekutimit në bazë të dokumentit të besueshem, me tej ka arsyetuar se fatura është e rregullt, është e nënshkruar nga “klienti” – debitori, pasi qe i njëjti e ka pranuar ne mënyre te rregullt. Prandaj, gjykata e shkallës së parë si në rastin konkret, ka vendosur duke vlerësuar se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara ne nenin 71 të LPP-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par 2 të LPK-së, për arsye se i njëjti nuk është i kuptueshem, i qartë dhe se nuk përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që nuk mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të hetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e cila vihet në dyshim me pretendim ankimor,

gjkata përmbartimore gabimisht e ka aplikuar ligjin e së cilën rrethane, gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykate vlerëson së në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë duhet të shqyrtoj mundësin e hapjes se seancës gjyqësore në të cilën të ftohen palët dhe të deklarohen në rastin konkret lidhur me marrëveshjen – kontratën, nga e cila supozohet se derivon dokumenti përmbartues – fatura. Gjkata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se duke u bazuar në dispozitën e nenit 73 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Gjkata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.* Mirëpo kjo gjykate vlerëson se për të sqaruar çdo rrethanë lidhur me këtë çështje palët duhet të ftohen në seance gjyqësore dhe të deklarohen lidhur me faktin, se mbi çfarë baze derivon fatura.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që të bëjë eliminimin e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që të ftoje palët dhe të dëgjohen përkitazi me çështjen, pastaj të analizohen dhe vlerësohen edhe pretendimet e paraqitura dhe të merr një vendim meritorë të drejt dhe të ligjshëm. Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së, e në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.54/24, me datën 05.03.2024**

**Gj y q t a r i,**  
**Faton Bajrami d.v.**